



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:150621
Datë: 15.04.2024
Numri i dokumentit: 05571072

PA1.nr.423/24

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, – kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Mehmet Ndrecaj kryetar i kolegjit, Ferit Osmani dhe Abdullah Ahmeti - anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Rrezarta Bala, në çështjen penale kundër të akuzuarit D. V. , nga O, për shkak të veprës penale Falsifikim i dokumenteve, nga neni 398 par.1, të KPRK-së dhe veprës penale Legalizim i përmbajtjes së pavërtetë, nga neni 403 par.1 të KPRK-së, duke vendosur sipas ankesës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, P.nr.3766/16, datë 12.02.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur më 04.04.2024 mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. Me rastin e ankesës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë e sipas detyrës zyrtare për të akuzuarin D. V. , **NDRYSHOHET** aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, P.nr.3766/16, datë 12.02.2024, ashtu që Gjykata e Apelit e Kosovës ndaj të akuzuarit D. V. , përkitazi për veprën penale Legalizim i përmbajtjes së pavërtetë, nga neni 403 par.1 të KPRK-së, për të cilën është liruar nga akuza, e refuzon akuzën në kuptim të nenit 362 par.1 nën par.1.3 të KPPK-së, lidhur me nenin 107 par.8 të KPRK-së, për shkak të parashkrimit absolut të ndjekjes penale.

II. Ankesa e Prokurorisë Themelore në Prishtinë është jo lëndore.

III. Shpenzimet e procedurës penale bien në barrën e mjeteve buxhetore të gjykatës.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë, me aktgjykimin, P.nr.3766/16, datë 12.02.2024, të akuzuarin D. V. , për shkak të veprës penale Legalizim i përmbajtjes së pavërtetë, nga neni 403 par.1 të KPRK-së e ka liruar nga akuza, në kuptim të dispozitës së nenit 363 par.1 pika 1.3 me arsyetim se nuk është provuar se i njëjti e ka kryer veprën penale. Shpenzimet e procedurës bien në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate. Ndërsa për shkak të veprës Falsifikim i dokumenteve, nga neni 398 par.1, të KPRK-së, në kuptim të dispozitës së nenit 362 par.1 nënpar.1.3 të KPP-së është refuzuar akuza për shkak të parashkrimit absolut të ndjekjes penale. Shpenzimet e procedurës bien në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor ankesë ka ushtruar:

Prokurori Themelore në Prishtinë, për shkak të vërtetimit të gabueshëm ose jo të plotë të gjendjes faktike, nga neni 386 par.2 të KPP-së, duke i propozuar Gjykatës së Apelit të Kosovës, ankesën të e aprovoj si të bazuar, aktgjykimin e ankimuar të e ndryshoj ose të njëjtën të e anuloj dhe çështjen ta kthej në rigjykim dhe vendim.

Prokurori i Apelit, me parashtresën me shkrim PPA/II.nr.249/2024, datë 19.03.2024 ka propozuar që të aprovohet si e bazuar ankesa e prokurorisë, aktgjykimin i ankimuar të ndryshohet ose i njëjti të anulohet dhe çështja të kthehet në rigjykim.

Gjykata e Apelit pasi shqyrtoj të gjitha shkresat e kësaj çështje juridiko-penale, studioj aktgjykimin e ankimuar në kuptim të nenit 394 të KPPK-së, dhe pas vlerësimeve të pretendimeve në ankesë, gjeti se:

-Me rastin e ankesës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë, aktgjykimin i shkallës së parë detyrimisht ndryshohet sikurse në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Duke shqyrtuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë në pjesën për të cilën është ushtruar ankesa, sipas detyrës zyrtare, konform dispozitës së nenit 394 të KPPK-së, përkitazi me vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, Gjykata e Apelit vlerëson se në rastin konkret e drejta në ndjekje penale është parashkruar.

Nga shkresat e lëndës del i akuzuari D. V. , është liruar nga akuza për veprën penale Legalizim i përmbajtjes së pavërtetë, nga neni 403 par.1 të KPRK-së, (i cili ishte në fuqi gjatë kohës kur është kryer vepra penale), për të cilin parashihet dënimi me burgim prej 3 (tre) muajsh deri në 5 (pesë) vite. Sipas dispozitës së nenit 106 par.1 nën par 1.4, të KPRK-së (Ligjit që ka qenë në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale), për vepër penale të dënueshme me më shumë se 3 (tre) vite burgim, ndjekja penale nuk mund të ndërmerret nëse kanë kaluar 5 (pesë) vite, nga koha e kryerjes së veprës penale (parashkrimi relativ), ndërsa sipas dispozitës së nenit 107 par.8 të KPRK-së, ndjekja penale ndalohet në çdo rast kur të ketë kaluar dyfishi i kohës së afatit të parashkrimit (ndalesa absolute mbi ndjekjen penale).

Nga shkresat e lëndës, rezulton se vepra penale nga i akuzuari është kryer më datë 21.03.2014, kurse afati i parashkrimit të ndjekjes penale fillon të rrjedhë nga data kur është kryer vepra penale. Në rastin konkret duke pasur parasysh se nga koha e kryerjes së veprës penale, ka kaluar dyfishi i kohës së afatit të parashkrimit, prej kohës së kryerjes së veprës penale e deri në dorëzim të lëndës Gjyqtarit të çështjes (02.04.2024) dhe në ditën e mbajtjes së seancës me dt.04.04.2024, ka kaluar më shumë se 10 (dhjetë) vite, nga këto arsye aktgjykimi i kundërshtuar është dashtë të ndryshohet sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi, me ç ‘rast ankesa e prokurorit është jo lëndore. Shpenzimet e procedurës penale konform dispozitës së nenit 454 par.1 të KPPK-së bien në barrën e mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

Nga sa u tha më lartë, konform dispozitës së nenit 403 të KPPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS

PA1.nr.423/24, datë 04.04.2024

Zyrtarja ligjore

Rrezarta Bala

Anëtarët e kolegjit:

Ferit Osmani

Kryetari i kolegjit

Mehmet Ndrecaj

Abdullah Ahmeti